



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

KOMUNIKATË PËR SHYTP

Bazuar në kërkesat ligjore të Ligjit Nr.04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) si dhe bazuar në nenin 17.7 të Shtojcës së këtij Ligji, AKP gjegjësisht Autoriteti i Likuidimit (AL) publikon Raportin e Përgjithshëm Vjetor lidhur me mbarëvajtjen e procesit të likuidimit për vitin 2016.

Ky raport vihet në dispozicion për inspektim nëse kërkohet nga kreditorët e konfirmuar si dhe publikohet në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

[http://www.pak-ks.org/repository/docs/Report for the calendar year - 2016 \(Alb\).pdf](http://www.pak-ks.org/repository/docs/Report%20for%20the%20calendar%20year%20-%202016%20(Alb).pdf)

Raporti mes tjerash përmban edhe informatat që kërkohen sipas nenit 17 pika 7 nënparagrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni që përfshin:

- 7.1. listën e pronave të shitura, transferuara apo të zgjidhura në mënyra tjera;
- 7.2. lista e pranimeve dhe pagesave të parasë së gatshme;
- 7.3. indikacion, nëse ka, të përfundimit të mundshëm të likuidimit; dhe
- 7.4. shpjegim të të gjitha çështjeve që zvarritin përmbylljen e rastit të likuidimit.

Agjencia mbetet e përkushtuar në kryerjen e mandatit të saj ligjor, në ngritjen edhe më tej të nivelit të transparencës në lidhje me mbarëvajtjen e punëve dhe proceseve që janë nën mandatin e AKP-së.

FUND